

**AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR**

VISTA INVESTMENT SH.P.K.

Data 8 Shtator 2025



TABELA E LËNDËS

KREU I. TË PËRGJITHSHME	3
NENI 1.01 PËRKUFIZIME	3
NENI 1.02 INTERPRETIMI	3
NENI 1.03 EMRI I SHOQËRISË DHE ORTAKËT	4
NENI 1.04 OBJEKTI I VEPRIMTARISË	4
NENI 1.05 KOHËZGJATJA.....	4
NENI 1.06 SELIA.....	4
NENI 1.07 VULA.....	5
NENI 1.08 DEGËT, ZYRAT E PËRFAQËSIMIT DHE SHOQËRITË E KONTROLLUARA	5
KREU II. KAPITALI I REGJISTRUAR.....	5
NENI 2.01 VLERË DHE PAGESAT E KAPITALIT TË REGJISTRUAR	5
NENI 2.02 KALIMI ME KONTRATË I KUOTAVE	5
NENI 2.03 KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI	6
NENI 2.04 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË REGJISTRUAR.....	6
NENI 2.05 ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË REGJISTRUAR	6
KREU III. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME	7
NENI 3.01 THIRRJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME	7
NENI 3.02 MBLEDHJET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME	7
NENI 3.03 VOTAT E ORTAKËVE.....	8
NENI 3.04 VOTIMI ME PROKURË	8
KREU IV. ADMINISTRATORI	9
NENI 4.01 EMËRIMI I ADMINISTRATORIT.....	9
NENI 4.02 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT.....	9
NENI 4.03 SHPËRBLIMI DHE PËRFITIMET E TJERA	9
KREU V. DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN E REGJISTRUAR	10
NENI 5.01 DIVIDENDËT.....	10
NENI 5.02 KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN E REGJISTRUAR	10
KREU VI. PRISHJA DHE NJOFTIMET	10
NENI 6.01 PRISHJA DHE LIKUIDIMI	10
NENI 6.02 NJOFTIMET	10



KREU I. TË PËRGJITHSHME

Neni 1.01 Përkufizime

“**Administrator**” ka kuptimin e cilitdo administratori të emëruar sipas parashikimeve të Neni 4.01 (*Emërimi i Administratorit*) i këtij Statuti.

“**Asambleja e Përgjithshme**” është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë, i cili mbledhet dhe ushtron kompetencat e veta përmes pjesëmarrjes së Ortakëve që përbëjnë kuorumin e nevojshëm për marrjen e vendimeve, sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe Ligjit.

“**Ditë të Plota**” në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

“**Kuota**” ka kuptimin e kuotave të Ortakëve siç parashikohen të Neni 2.01 (*Vlera dhe Pagesat e Kapitalit të Regjistruar*) i këtij Statuti.

“**Ligji**” është ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar.

“**Ortaku**” ose “**Ortakët**” ka kuptimin që i jepet të Neni 1.03(b) (*Emri i Shoqërisë dhe Ortakët*) i këtij Statuti.

“**QKB**” ka kuptimin e institucionit sipas ligjit nr.9723 datë 3.5.2007 “*Për regjistrimin e biznesit*” i ndryshuar, si dhe çdo institucion tjetër që në të ardhmen mund të marrë kompetencat e këtij institucioni.

“**Statuti**” ka kuptimin e këtij statuti.

“**Shoqëria**” ka kuptimin që i jepet të Neni 1.03(a) (*Emri i Shoqërisë dhe Ortakët*) i këtij Statuti.

Neni 1.02 Interpretimi

- (a) Çdo e drejtë, detyrim, apo kusht i përshkruar në këtë Statut duhet të interpretohet në kontekstin e Statutit të marrë si i tërë dhe duke marrë në konsideratë qëllimet që nxitën Ortakët për të themeluar Shoqërinë. Titujt e krerëve, neneve, paragrafëve, nënparagrafëve që përmban ky Statut janë vetëm për referencë dhe nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë në kuptimin apo interpretimin e këtij Statuti. Të gjitha anekset dhe shtojcat bashkëngjitur apo referuar, janë të inkuorpuara dhe janë pjesë integrale e këtij Statuti. Nëse një fjalë e përdorur në ndonjë aneks apo shtojcë fillon me gërmë kapitale por nuk është e përkufizuar në këtë aneks apo shtojcë, do të ketë kuptimin e përkufizuar në këtë Statut. Kur në tekstin e këtij Statuti ka referenca për një kre, nen, paragraf, nënparagraf, aneks, shtojcë, të tilla referenca lidhen me kreun, nenin, paragrafin, nënparagrafin, aneksin apo shtojcën e këtij Statuti, përveçse kur përcaktohet ndryshe.
- (b) Përveçse në rastet kur thuhet shprehimisht ndryshe, në këtë Statut:

- (i) Fjalët e përdorura në numrin njëjës përfshijnë edhe ato të përdorura në numrin shumës;
- (ii) Fjalët e përdorura në një rasë apo gjini përfshijnë, sipas kontekstit, edhe rasat dhe gjinitë e tjera;
- (iii) Nëse një fjalë është e përkufizuar, edhe format e tjera gramatikore do të kenë kuptimin përkatës; dhe
- (iv) Fjala “përfshin”, do të thotë “përfshin, pa u kufizuar”, pavarësisht nëse ky togfjalësh e pason ose jo.

Neni 1.03 Emri i Shoqërisë dhe Ortakët

- (a) Sot më datë 8 Shtator 2025, themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emër Vista Investment shpk (në vijim “**Shoqëria**”).
- (b) Themeluesit e Shoqërisë janë (ku në vijim do të referohen së bashku si “**Ortakët**” dhe veç e veç si “**Ortaku**”):
 - (i) Agron Shaplo, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, atësia Zija, lindur në Tiranë më 20.04.1953, identifikuar me letërnjoftim ID me numër 028884145;
 - (ii) Alfred Rushaj, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, atësia Gjovalin, lindur në Lezhë më 19.05.1974, identifikuar me letërnjoftim ID me numër 034630290.

Neni 1.04 Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria do të ushtrojë veprimtari në fushën e investimit, zhvillimit, ndërtimit, rikonstruksionit, administrimit dhe shfrytëzimit të pasurive të paluajtshme të çdo lloji, përfshirë toka, ndërtesa banimi, objekte tregtare, komplekse turistike, struktura shërbimi, industriale apo çdo pasuri tjetër të ngjashme. Shoqëria mund të blejë, shesë, japë ose marrë me qira, me enfiteozë, të vendosë barrë hipotekore, apo të ushtrojë çdo formë tjetër të qarkullimit civil të pasurive të paluajtshme ose të drejtave reale, si dhe të ndërmarrë veprime për shfrytëzimin efektiv të tyre. Shoqëria mund të përgatisë, financojë dhe zbatojë projekte ndërtimore dhe zhvillimore, duke përfshirë studimin e tregut, hartimin e planeve të investimit, sigurimin e burimeve financiare për realizimin e tyre, përmes kapitalit të vet, kredive, garancive, partneriteteve apo çdo forme tjetër financimi të lejuar nga ligji. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër plotësues që lidhet drejtpërdrejt me investimin, zhvillimin dhe administrimin e pasurive të paluajtshme, përfshirë menaxhimin e tyre, ofrimin e shërbimeve të lidhura dhe çdo veprim tjetër që i shërben qëllimit kryesor të Shoqërisë. Në çdo rast, Shoqëria mund të ushtrojë edhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji, i cili lidhet ose është i nevojshëm për realizimin e objektit të saj të veprimtarisë.

Neni 1.05 Kohëzgjatja

Shoqëria do të operojë pa kohëzgjatje të përcaktuar.

Neni 1.06 Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Ibrahim Rugova”, 64. Tirane.



Neni 1.07 Vula

Shoqëria ka vulën e saj mbi të cilën ka të shkruar emërtimin e saj tregtar.

Neni 1.08 Degët, Zyrat e Përfaqësimit dhe Shoqëritë e Kontrolluara

Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësimi dhe shoqëri të kontrolluara brenda Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, si dhe të marrë pjesë si ortak/aksionar në shoqëri të tjera.

KREU II. KAPITALI I REGJISTRUAR

Neni 2.01 Vlera dhe Pagesat e Kapitalit të Regjistruar

- (a) Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
- (i) Ortaku: Agron Shaplllo
Vlera e kontributit: 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë
Kuota e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë: 50% (pesëdhjetë për qind)
Numri i kuotave: 1 (një)
- (ii) Ortaku: Alfred Rushaj
Vlera e kontributit: 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë
Kuota e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë: 50% (pesëdhjetë për qind)
Numri i kuotave: 1 (një)
- (b) Secili Ortak do të bëjë pagesën e kontributit në kapitalin e regjistruar në llogarinë bankare të Shoqërisë, jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB.

Neni 2.02 Kalimi me Kontratë i Kuotave

- (a) Kur një Ortak dëshiron të shesë Kuotën e tij plotësisht apo pjesërisht, Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes. Kuota duhet t'i ofrohet së pari Ortakëve të tjerë me të njëjtat kushte që do t'i ofrohej të tretëve, në përpjestim me Kuotën që zotërojnë ortakët e tjerë në Shoqëri.
- (b) Ortakët e tjerë mund të shfaqin interes për blerjen e Kuotës jo më vonë se dy javë pas marrjes së propozimit nga Ortaku që dëshiron të shesë Kuotën. Nëse Ortakët nuk shprehen brenda këtij afati, heshtja do të konsiderohet si refuzim dhe Ortaku do të konsiderohet se e ka respektuar të drejtën e parablerjes. Nëse një Ortak nuk do të ushtrojë të drejtën e parablerjes apo e ka humbur atë, Ortaku apo Ortakët e tjerë kanë të drejtën e blerjes së Kuotës në shitje.
- (c) Pas respektimit të së drejtës së parablerjes, Ortaku që dëshiron të shesë Kuotën mund të negociojë me të tretët për të shitur Kuotën me kushtet që iu parashtruan Ortakëve të tjerë kur u përmbush e drejta e parablerjes. Nëse negociatat mes Ortakut dhe personit të interesuar për të blerë Kuotën ndryshojnë kushtet e shitjes, e drejta e parablerjes rinovohet.



- (d) Është e ndaluar shitja apo ndonjë mënyrë tjetër kalimi pronësie i Kuotës te të tretët, kur Asambleja e Përgjithshme nuk ka dhënë vendim për pranimin paraprak të kalimit te i tretë. Kur një prej Ortakëve të tjerë dëshiron të blejë Kuotën, për këtë shitje nuk është i nevojshëm të merret miratimi i Asamblesë së Përgjithshme. Ortaku që planifikon të kalojë pronësinë e Kuotës së tij nuk përjashtohet nga votimi për këtë vendimmarrje.
- (e) Nëse Asambleja e Përgjithshme refuzon kalimin e Kuotës, Administratorët do të njoftojnë për mospranimin Ortakun që do të shesë Kuotën, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në Shoqëri kërkesa për miratimin e kalimit të Kuotës.

Neni 2.03 Kalimi i Kuotave me Trashëgimi

- (a) Nëse një Ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët e tij (në rastet kur Kuota trashëgohet bashkërisht) do të jenë të vetmit persona që Shoqëria do të njohë si mbajtës të të drejtave mbi Kuotën përkatëse. Megjithatë, vdekja e Ortakut nuk e përjashton ortakun e ri trashëgimtar nga përgjegjësitë e lidhura me Kuotën, qofshin këto detyrime që lidhen me kontribute të papaguara apo me detyrime të tjera ndaj Shoqërisë. Këto përgjegjësi, të cilat rëndonin mbi Ortakun në momentin e vdekjes së tij, do të vazhdojnë të ekzistojnë dhe do të shlyhen nga pasuria e tij trashëgimore, pavarësisht nga kalimi i Kuotës te trashëgimtarët.
- (b) Nëse trashëgimtari ose trashëgimtarët heqin dorë nga Kuota ose dëshirojnë t'ia kalojnë atë një personi tjetër, kjo mund të bëhet vetëm nëse personi që supozohet të marrë në pronësi Kuotat, miratohet paraprakisht nga Asambleja e Përgjithshme.
- (c) Personi që fiton pronësinë mbi një Kuotë si pasojë e vdekjes të një Ortaku, ushtron të gjitha të drejtat pasurore që rrjedhin nga zotërimi i kësaj Kuote, përfshirë të drejtën për të përfituar dividendë, edhe përpara regjistrimit të tij si ortak në QKB.

Neni 2.04 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar

- (a) Zmadhimi i kapitalit të regjistruar mund të bëhet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë sipas nenit 87.1 të Ligjit, nëpërmjet kontributeve në para, kontributeve në natyrë, ose nëpërmjet përfshirjes së rezervave apo fitimit në kapitalin e regjistruar.
- (b) Zmadhimi i kapitalit të regjistruar mund të bëhet sipas formave të parashikuara më poshtë:
 - (i) duke rritur proporcionalisht vlerën e Kuotave të gjithë Ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës, pasi gjithë Ortakët kanë derdhur apo premtuar për të derdhur kontributet përkatëse;
 - (ii) duke rritur proporcionalisht vlerën e Kuotave të disa Ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës, pasi ata Ortakë kanë derdhur apo premtuar për të derdhur kontributet përkatëse;
 - (iii) duke pranuar kontribute nga një ortak i ri në Shoqëri, pasi është marrë vendimi nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 2.05 Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar

- (a) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te Shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë sipas nenit 87.1 të Ligjit.



- (b) Zvogëlimi i kapitalit të regjistruar mund të bëhet sipas formave të parashikuara më poshtë:
 - (i) duke ulur proporcionalisht vlerën e Kuotave të gjithë Ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës;
 - (ii) me anulimin e ndonjë apo disa Kuotave, sipas përcaktimeve të Ligjit dhe Statutit.

KREU III. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 3.01 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- (a) Administratori thërret Asamblenë e Përgjithshme (i) sa herë që ai e gjykon të arsyeshme dhe në interes të Shoqërisë, (ii) kur ka detyrim për ta thirrur asamblenë sipas Ligjit dhe, (iii) me kërkesën e Ortakëve sipas nenit 84 të Ligjit.
- (b) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të një njoftimi të dërguar me postë ose me postë elektronike (e-mail) drejtuar çdo Ortaku, duke përfshirë edhe përfaqësuesin e Kuotave në zotërim të përbashkët, nëse ka të tillë. Njoftimi duhet të dërgohet të paktën 7 (shtatë) Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen. Ky afat mund të shkurtohet vetëm nëse të gjithë Ortakët japin miratimin e tyre unanimit për një njoftim me afat më të shkurtër.
- (c) Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme konsiderohen të pavlefshme nëse nuk është kryer njoftimi ose nëse personat që kanë të drejtë të marrin pjesë, nuk kanë marrë njoftimin për mbledhjen sipas mënyrës së përcaktuar në Statut. Përkrahshimisht, mbledhja do të konsiderohet e vlefshme nëse Shoqëria arrin të provojë se personi në fjalë i ka dhënë Shoqërisë një adresë të pasaktë ose të paplotë, gjë që ka pamundësuar dërgimin dhe marrjen e njoftimit.

Neni 3.02 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

- (a) Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga fjalia e parë e nenit 86.1 të Ligjit, përveç kur sipas Ligjit apo këtij Statuti merren vendime që kërkojnë shumicë më të lartë, rast në të cilin arritja e kuorumit realizohet sipas fjalisë së dytë të nenit 86.1 të Ligjit. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë me rregullore të veçantë rregullat që lidhen me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve në mënyrë elektronike, përfshirë mënyrën e njoftimit, pjesëmarrjes dhe votimit në këto mbledhje.
- (b) Administratori kryeson mbledhjen dhe cakton një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
- (c) Nëse Administratori nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse ai nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, Ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- (d) Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen



e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast se shtyrja është më e vogël se katërmëdhjetë ditë, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme. Njoftimi nuk është i nevojshëm edhe në rast se Ortakët në vendimin për shtyrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme kanë përcaktuar datën dhe orën e mbledhjes.

- (e) Asambleja e Përgjithshme vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:
- (i) Kryetari; ose
 - (ii) një Ortak ose Ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i Ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë Ortaku.

Neni 3.03 Votat e Ortakëve

- (a) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga Kuotat, çdo Kuotë i jep Ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose Ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote me peshë në votim sipas përcaktimeve në paragrafin e mëposhtëm.
- (b) Në përputhje me nenin 88.1 të Ligjit, pesha e votës që do të ketë secili Ortak në Asamblenë e Përgjithshme, do të jetë si më poshtë:
- (i) Ortaku Agron Shapllo do të ketë të drejtën e votës në masën 50% (pesëdhjetë për qind);
 - (ii) Ortaku Alfred Rushaj do të ketë të drejtën e votës në masën 50% (pesëdhjetë për qind).

Neni 3.04 Votimi me Prokurë

- (a) Çdo Ortak ka të drejtë të caktojë një përfaqësues për të marrë pjesë dhe për të votuar në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë. Emërimi i përfaqësuesit bëhet me anë të një prokure të nënshkruar nga Ortaku përkatës. Prokura duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme për identifikimin e përfaqësuesit dhe mbledhjen për të cilën ai autorizohet të veprojë, si dhe datën e nënshkrimit.
- (b) Nëse Ortaku dëshiron t'i japë udhëzime specifike përfaqësuesit lidhur me mënyrën e votimit mbi çështjet që do të shqyrtohen në Asamblenë e Përgjithshme, ai mund të përfshijë këto udhëzime në tekstin e prokurës. Në këto raste, prokura duhet të përcaktojë qartë për secilin vendim në rendin e ditës nëse përfaqësuesi duhet të votojë pro, kundër, apo të abstenojë. Përfaqësuesi ka të drejtë të veprojë sipas udhëzimeve të dhëna nga Ortaku dhe, në mungesë të udhëzimeve specifike për çështje të caktuara, mund të vendosë të votojë ose të abstenojë sipas gjykimit të tij.



- (c) Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratori depozitohet dhe ruhet në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga Shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

KREU IV. ADMINISTRATORI

Neni 4.01 Emërimi i Administratorit

- (a) Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të Shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.
- (b) Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.
- (c) Zj. Androniqi Shollo, shtetase shqiptare, lindur në Fier, Shqipëri më 16.02.1964, identifikuar me letërnjoftim ID me numër personal G45216177K dhe numër letërnjoftimi 033435495 caktohet Administratore e Shoqërisë me një mandat 5 vjeçar që fillon në datën e nënshkrimit të këtij Statuti.
- (d) Specimeni nënshkrimit të administratorit Androniqi Shollo paraqitet si më poshtë:



Neni 4.02 Kompetencat e Administratorit

- (a) Politikat tregtare të Shoqërisë, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, zbatohen nga Administratori. Ky i fundit ushtron të gjitha kompetencat që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 81 të Ligjit, si dhe kompetencat që i njihen atij në bazë të nenit 95 të Ligjit. Ndryshimet e Statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorit, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

Neni 4.03 Shpërblimi dhe Përfitimet e Tjera

- (a) Administratori shpërblehet në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e nenit 97 të Ligjit.
- (b) Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në Shoqëri, Shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë



Shoqëri të kontrolluara ose për Shoqëri paraardhëse të Shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.

KREU V. DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN E REGJISTRUAR

Neni 5.01 Dividendët

- (a) Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, Shoqëria me shumicën e votave të Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 87.1 të Ligjit, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve të Ortakët në proporcion me Kuotat e zotëruara prej tyre sipas parashikimeve të Neni 2.01 i këtij Statuti.
- (b) Të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumën e paguar për Kuotat për të cilat paguhet dividendi. Dividendët ndahen dhe paguhen ndërmjet ortakëve në mënyrë proporcionale me vlerën që ata kanë paguar për Kuotat e tyre në kapitalin e shoqërisë. Secili Ortak merr dividend sipas masës së kapitalit që ka kontribuar dhe për kohën që ka qenë Ortak gjatë periudhës për të cilën shpërndahet dividendi. Në rast se Kuota nënshkruhet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- (c) Asnjë dividend ose pagesë tjetër në para, që i takon një Ortaku për shkak të zotërimit të një Kuate, nuk do të krijojë të drejtën për përfitimin e interesave ndaj Shoqërisë, nëse pagesa nuk tërhiqet menjëherë nga Ortaku, përveç rasteve kur një e drejtë e tillë është parashikuar shprehimisht në lidhje me atë Kuate.

Neni 5.02 Kalimi i Fitimeve në Kapitalin e Regjistruar

Asambleja e Përgjithshme me shumicë votash sipas nenit 87.1 të Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të Shoqërisë.


KREU VI. PRISHJA DHE NJOFTIMET

Neni 6.01 Prishja dhe Likuidimi

- (a) Vendimi për likuidimin vullnetar të Shoqërisë merret nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet të miratojë këtë vendim me shumicën e kërkuar sipas nenit 87.1 të Ligjit.
- (b) Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve sipas këtij Statuti.

Neni 6.02 Njoftimet

- (a) Të gjitha njoftimet e bëra nga çdo person, në përputhje me parashikimet e këtij Statuti, duhet të jenë me shkrim ose të dërgohen nëpërmjet komunikimit elektronik, në adresat e përcaktuara më poshtë. Njoftimet konsiderohen të vlefshme në lidhje me kohën dhe personin që kryen njoftimin, për sa kohë janë dërguar në përputhje me mënyrat dhe adresat e përcaktuara për këtë qëllim.



- (b) Shoqëria mund t'i dërgojë një Ortaku njoftimet përkatëse në njërin nga format e mëposhtme: (i) dorazi, (ii) me postë të regjistruar ose letër porosi me kthim përgjigje, në adresën e regjistruar të Ortakut pranë Shoqërisë, ose (iii) në adresën e postës elektronike (e-mail), të përcaktuar më poshtë ose që Ortaku ia ka komunikuar Shoqërisë më vonë për qëllime njoftimi.
- (c) Në rast se një Kuotë zotërohet bashkërisht nga disa persona, njoftimet i dërgohen përfaqësuesit të tyre të përbashkët, i emëruar në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit.
- (i) Adresat e njoftimit të Shoqërisë do të jenë:
- (ii) Email: ninapuleri@yahoo.com
- (iii) Tel: 0696006791

Emrat dhe nënshkrimet e ortakëve:

Agron Shaplo

Agron Shaplo 

Alfred Rushaj

ALFRED RUSHAJ



